



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 28 qershor 2024

Njoftim për shtyp

Ndryshimet më të rëndësishme në borxhin e jashtëm, kërkesat e jashtme dhe pozitën investuese ndërkombëtare: tremujori i parë i vitit 2024

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, **borxhi i jashtëm bruto** është 11.789 milionë euro dhe shënoi një rritje tremujore prej 327 milionë euro. **Kërkesat e jashtme bruto** u rritën për 436 milionë euro dhe arrijnë në 7.440 milionë euro. Rritja më e madhe tremujore e detyrimeve në raport me kërkesat çoi në uljen e **borxhit të jashtëm neto** për 109 milionë euro, kështu që në fund të muajit mars të vitit 2024 shënojnë 4.350 milionë euro.

Borxhi i jashtëm dhe pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut

	31.12.2023		31.03.2024		Ndryshimet tremujore		
	mil. EUR	% PBB	mil. EUR	% PBB	mil. EUR	%	p.p.
Borxhi i jashtëm bruto	11,462.7	83.9	11,789.4	81.0	326.7	2.9	-3.0
Borxhi i jashtëm bruto – Pa përfshirë borxhin e Bankës Qendrore nga marrëveshjet repo	11,097.0	81.3	11,215.3	77.0	118.3	1.1	-4.2
Borxh afatgjatë	8,592.8	62.9	8,624.0	59.2	31.2	0.4	-3.7
Borxh afatshkurtër	2,869.9	21.0	3,165.4	21.7	295.5	10.3	0.7
<i>Borxh afatshkurtër pa repo</i>	<i>2,504.2</i>	<i>18.3</i>	<i>2,591.3</i>	<i>17.8</i>	<i>87.1</i>	<i>3.5</i>	<i>-0.5</i>
Borxhi publik	5,578.5	40.9	5,826.0	40.0	247.5	4.4	-0.8
<i>Borxh publik pa repo</i>	<i>5,212.9</i>	<i>38.2</i>	<i>5,252.0</i>	<i>36.1</i>	<i>39.1</i>	<i>0.8</i>	<i>-2.1</i>
Borxhi privat	5,884.2	43.1	5,963.3	41.0	79.2	1.3	-2.1
Kërkesat e jashtme bruto	7,004.2	51.3	7,439.8	51.1	435.6	6.2	-0.2
Kërkesat e jashtme bruto – Pa përfshirë kërkesat e Bankës Qendrore nga marrëveshjet e anasjellta repo	7,004.0	51.3	7,083.4	48.6	79.3	1.1	-2.6
Borxhi i Jashtëm Neto	4,458.5	32.6	4,349.6	29.9	-108.9	-2.4	-2.8
Borxh i jashtëm neto pa repo	4,093.0	30.0	4,132.0	28.4	39.0	1.0	-1.6
PIN, neto	-8,500.1	-62.2	-8,506.2	-58.4	-6.1	0.1	3.8

*/Të dhënat për prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për vitin 2023 janë vlerësuar (burimi: Enti shtetëror për Statistikë, njoftimi "Prodhimi i brendshëm bruto, tremujori i parë 2024" prej datës 03.06.2024). Të dhënat për vitin 2024 janë parashikimet e BPRMV (prill, viti 2024).
Burimi: BPRMV, ESHS.

Pozita negative e investimeve ndërkombëtare neto¹, në fund të muajit mars të vitit 2024 arrin 8.506 milionë euro, ose 58,4% nga PBB²-së i projektuar për vitin 2024. Pjesën më të madhe të kësaj shume, ose 87%, e përbëjnë detyrimet neto të bazuara në investime direkte, nga të cilat 72% bazohen në kapitalin vetanak.

¹ Pozita Investuese Ndërkombëtare (PIN) është raport statistikor që tregon gjendjen e mjeteve dhe detyrimeve financiare të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në një datë të caktuar, d.m.th. kërkesat dhe detyrimet ndaj jorezidentëve bazuar në instrumente financiare. Për më tepër, pozita negative e investimeve ndërkombëtare neto do të thotë se detyrimet financiare tejkalojnë kërkesat financiare nga jorezidentët


² Të dhënat për PBB-në për vitin 2024 janë projektim i BPRMV(prill 2024).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Borxhi i jashtëm bruto

Në fund të muajit mars të vitit 2024, borxhi i jashtëm bruto shënon 11.789 milionë euro (ose 81% nga PBB-ja e projektuar) dhe shënon rritje tremujore prej 327 milionë euro (ose për 2,9%). Nëse përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore³ mbi borxhin, borxhi bruto shënoi rritje tremujore prej 118 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së borxhit privat (me 79 milionë euro) dhe borxhit publik (me 39 milionë euro). Rritja e borxhit privat vjen si pasojë e rritjes së borxhit të subjekteve kapitale (për 116 milionë euro) dhe sektorit privat jobankar (për 100 milionë euro), ndërsa borxhi i bankave private është ulur (me 136 milionë euro). Rritja tremujore e borxhit të jashtëm publik është kryesisht rezultat i rritjes së borxhit të sektorit "shtetëror" për 28 milionë euro dhe të bankave publike dhe ndërmarrjeve publike (për 8 milionë euro).



Burimi: BPRMV, EShS.




Kërkesat e jashtme bruto

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, kërkesat e jashtme bruto arrijnë 7.440 milionë euro (ose 51,1% nga PBB-ja e projektuar) dhe vërehet një rritje tremujore prej 436 milionë euro (ose për 6,2%). Nëse përjashtohet ndikimi i aktiviteteve specifike të bankës qendrore lidhur me menaxhimin e rezervave valutore, kërkesat e jashtme bruto janë rritur me 79 milionë euro dhe arrijnë në 7,083 milionë euro. Ky ndryshim tremujor është rezultat i rritjes së kërkesave private me 370 milionë euro, ndërsa kërkesat publike janë zvogëluar për 291 milionë euro. Rritja tremujore e kërkesave të jashtme në sektorin privat është rezultat i rritjes së kërkesave të subjekteve kapitale (me 325 milionë euro) dhe sektorit privat jobankar (për 105 milionë euro), në kushtet e reduktimit të kërkesave të bankave private (për 60 milionë euro).


³ Aktivitetet specifike për menaxhimin e rezervave valutore të bankës qendrore i referohen marrëveshjeve repo dhe operacioneve të tjera që lidhen me menaxhimin e rezervave valutore. Me rastin e përfundimit të këtyre transaksioneve krijohen detyrime (të klasifikuara në kategorinë "kredi") që kontribuojnë në rritjen e nivelit të borxhit bruto. Në të njëjtën kohë, gjatë përfundimit të këtyre transaksioneve në drejtim të kundërt, të arkëtueshmet e krijuara kontribuojnë në rritjen e të arkëtueshmeve bruto. Të marra në tërësi, këto transaksione kanë një efekt neutral në bazën neto nëse ato kryhen njëkohësisht në të njëjtën shumë. Nëse transaksionet e kryera nuk janë me shumë identike në të dy drejtimet, ato kanë ndikim në borxhin e jashtëm bruto dhe neto dhe në të arkëtueshmet bruto.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë




Burimi: BPRMV, EShS.




Borxhi i jashtëm neto

Më 31.3.2024, borxhi i jashtëm neto arrin 4.350 milionë euro (ose 29,9% nga PBB-ja e projektuar). Borxhi i jashtëm neto i vendit në tremujorin e parë të vitit 2024 është ulur për 109 milionë euro, ose për 2,4%. Për sa i përket strukturës, borxhi privat neto vazhdon të ketë një peshë më të madhe në totalin e borxhit neto për 62%.



Burimi: PBRMV, EShS.



Pozita investuese ndërkombëtare neto

Gjatë tremujort të parë të vitit 2024, pozita investuese ndërkombëtare neto (PIN) është rritur për 6 milionë euro dhe arrin në 8,506 milionë euro, që përfaqëson 58,4% të PBB-së së projektuar për vitin 2024.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë


Rritja tremujore e PIN-it neto negativ rezulton nga rritja më e madhe e detyrimeve (për 554 milionë euro) në raport me rritjen e mjeteve (për 547 milionë euro). Duke parë sipas instrumenteve, detyrimet neto të bazuara në instrumente të kapitalit janë rritur për 115 milionë euro, ndërsa detyrimet neto të bazuara në instrumente të borxhi janë zvogëluar për 109 milionë euro.

Pozita investuese ndërkombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut


(në milionë euro)

PIN, sipas instrumenteve	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	T1 2023	T2 2023	T3 2023	T4 2023	T1 2024
Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare neto	-5,082.7	-5,576.0	-5,822.5	-6,039.5	-6,458.4	-6,900.6	-7,244.9	-8,147.8	-8,140.4	-8,380.3	-8,340.0	-8,500.1	-8,506.2
Mjetet	4,571.9	5,171.3	5,157.3	5,913.6	6,163.8	6,172.5	7,041.4	7,648.1	8,109.6	8,348.8	8,226.1	8,394.6	8,942.1
Investimet direkte	655.0	811.9	967.6	896.2	936.8	784.3	915.5	996.2	1,201.3	1,317.9	1,468.0	1,061.0	1,394.6
Investimet e portofolit	212.6	255.2	300.2	321.2	406.1	470.9	650.0	695.3	736.3	778.8	810.7	917.0	956.4
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsonet e aksioneve të punonjësve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	1.0	1.2	2.8	2.9	4.4	4.5	6.0	6.0	5.6	5.0	5.1	5.2	5.4
Valuta dhe depozitat	615.4	627.3	635.5	694.0	580.0	562.9	657.6	653.5	561.9	604.7	676.5	650.9	611.7
Kreditë	67.1	52.1	56.1	74.5	79.1	87.3	125.9	221.6	154.6	158.7	188.0	74.9	434.0
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	757.4	809.6	858.8	1,057.2	894.4	902.3	1,042.3	1,212.4	1,290.5	1,293.5	1,175.6	1,146.8	1,252.6
Llogari tjera të arkëtueshme/pagueshme	1.7	0.5	0.1	0.5	0.3	0.4	0.9	0.3	0.2	0.4	0.5	0.6	0.3
Aktive reserve	2,261.8	2,613.4	2,336.3	2,867.1	3,262.6	3,359.9	3,643.3	3,862.9	4,159.2	4,189.7	3,901.7	4,538.4	4,287.1
Detyrimet	9,654.6	10,747.3	10,979.8	11,953.0	12,622.2	13,073.1	14,286.3	15,795.9	16,250.0	16,729.1	16,566.0	16,894.7	17,448.3
Investimet direkte	4,951.3	5,392.2	5,598.1	6,141.3	6,580.0	6,537.1	7,089.2	7,853.6	8,223.2	8,473.6	8,688.3	8,492.0	8,836.6
Investimet e portofolit	848.8	1,362.2	1,476.3	1,813.2	1,730.7	2,103.8	2,159.2	2,106.7	2,564.3	2,592.1	2,225.2	2,319.0	2,206.0
Derivatet financiare (përveç rezervave) dhe opsonet e aksioneve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kapitalet tjera	4.3	6.0	2.3	4.2	4.0	5.0	2.7	3.3	3.3	3.4	3.2	3.2	3.3
Valuta dhe depozitat	148.5	174.2	195.2	206.2	254.2	253.3	297.3	471.0	363.4	398.9	300.1	462.0	335.4
Kreditë	2,961.7	3,014.7	2,872.0	2,883.4	3,100.9	3,267.2	3,580.3	4,043.3	3,793.6	3,952.6	4,014.6	4,264.2	4,638.2
Sigurimet, pensionet dhe skemat e standardizuara garancie	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kreditë tregtare dhe avanset	656.7	714.6	757.7	824.8	871.1	827.8	910.3	1,062.6	1,053.6	1,063.7	1,085.4	1,110.2	1,181.6
Llogari tjera të arkëtueshme/pagueshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.4	0.0	5.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të drejta të veçanta të arkëtimit (lindja e detyrimeve neto)	83.2	83.2	78.2	79.8	81.3	77.4	247.3	250.5	248.5	244.8	249.2	244.2	247.2

Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV, EShs.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione mbështetëse

Të dhënat e serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat e jashtme bruto: https://www.nbrm.mk/nadvoresen_dolg-al.nspix

Të dhënat të serive kohore - të dhëna vjetore dhe tremujore për pozitën e investimeve ndërkombëtare:

https://www.nbrm.mk/megunarodna_investiciska_pozicija-al.nspix

Shpjegime metodologjike mbi borxhin e jashtëm bruto dhe kërkesat:

http://nbrm.mk/content/statistika/ND/metodologija/Metodologija_nadvoresen_dolg_5_2_2018.pdf

Shpjegime metodologjike për pozitën e investimit ndërkombëtar:

http://nbrm.mk/content/statistika/mip/metodologija/Metodologija_MIP_BPM6_9_10_2018.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave:

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Borxhi i jashtëm bruto tremujor, kërkesat e jashtme bruto dhe pozita e investimeve ndërkombëtare: 30 shtator 2024 (seksioni i referencës që nga qershori 2024).

Për pyetje nga mediat, ju lutemi kontaktoni personat përgjegjës nga Kabineti i Guverntorit.

Për informata më të detajuara lidhur me të dhënat statistikore të publikuara, mund të na kontaktoni në contact.statistika@nbrm.mk ose në telefon 02 3215 181 lokal 103 (ose 110/108).